




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



## RREGULLORE NR.06/2016 PËR NDËRPRERJE NGA SHËRBIMET E UJIT NË KOSOVË



Nëntor 2016

## PËRMBAJTJA

|   |    |
|---|----|
| <b>KREU I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b> .....  | 3  |
| Neni 1: Qëllimi .....   | 3  |
| Neni 2: Fushëveprimi.....   | 3  |
| Neni 3: Përkufizimet .....  | 3  |
| Neni 4: Rregullat e Interpretimit .....   | 6  |
| Neni 5: Aplikueshmëria .....  | 6  |
| Neni 6: Parimet e përgjithshme .....  | 6  |
| <b>KREU II HETIMI DHE EKZEKUTIMI I NDËRPRERJES NGA SHËRBIMET E UJIT</b> .....                         | 7  |
| Neni 7: Hetimi i rastit nga ofruesi i shërbimeve para se të zbatohet ndërprerja .....                 | 7  |
| Neni 8: Ekzekutimi i ndërprerjes .....  | 8  |
| Neni 9: Pezullimi i ndërprerjes .....   | 8  |
| <b>KREU III BAZAT DHE PROCEDURAT E NDËRPRERJES NGA SHËRBIMET E UJIT</b> .....                         | 8  |
| Neni 10: Ndërprerja për shkak të rrezikut të drejtpërdrejtë .....                                     | 8  |
| Neni 11: Ndërprerja për qëllime operacionale .....  | 9  |
| Neni 12: Ndërprerja me kërkesë të konsumatorit .....  | 9  |
| Neni 13: Ndërprerja kur konsumatori ka shkelur kontratën e shërbimeve dhe kartën e konsumatorit ..... | 9  |
| Neni 14: Ndërprerja për mospagesë të faturave .....   | 10 |
| Neni 15: Ndërprerja për objektin i cili është i lidhur në mënyrë të pa autorizuar .....               | 10 |
| Neni 16: Ndërprerja për shkak të refuzimit të konsumatorit për të pasur qasje në pronë10              |    |
| Neni 17: Ndërprerjet për shkak të rrjedhjeve të jashtme të dukshme.....                               | 11 |
| Neni 18: Ndërprerja për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të shërbimeve të ujës-jellësit.....    | 12 |
| Neni 19: Ndërprerja në prona të braktisura.....   | 12 |
| Neni 20: Ankesat drejtuar komisionit këshillues të konsumatorëve .....                                | 12 |
| Neni 21: Përlllogaritja e kohës së shfrytëzimit të shërbimeve nga konsumatori .....                   | 13 |
| <b>KREU IV PËRMBAJTJA E NJOFTIMIT DHE VËREJTJES PËR NDËRPRERJE DHE KOMPENZIMI</b> 13                  |    |
| Neni 22: Përmbajtja e njoftimit për ndërprerje .....  | 13 |
| Neni 23: Përmbajtja e vërejtjes për ndërprerje .....  | 13 |
| Neni 24: Kompensimi .....   | 14 |
| Neni 25: Rilidhja nga ofruesi i shërbimeve.....   | 14 |
| Neni 26: Rilidhja e paautorizuar dhe manipulimi me ujëmatës.....                                      | 14 |
| Neni 27: Rilidhja e shërbimeve në prona të braktisura .....   | 15 |
| Neni 28: Refuzimi për rilidhje.....   | 15 |
| Neni 29: Konfiskimi i pajisjes për shërbime të ujit.....  | 15 |
| Neni 30: Paradhënia .....   | 16 |
| <b>KREU VI MARRËVESHJA PËR PAGESË</b> .....   | 17 |
| Neni 31: Marrëveshjet për pagesë .....  | 17 |
| Neni 32: Kontestimi i besueshmërisë së faturave.....  | 18 |
| Neni 33: Pagesat për vërejtje, ndërprerje dhe rilidhje .....  | 19 |
| <b>KREU VII: ZBATIMI, DËNIMET DHE ANKESAT</b> .....   | 19 |
| Neni 34: Zbatimi i rregullores për ndërprerje dhe rilidhje.....                                       | 19 |
| Neni 35: Shënimet dhe raportet mbi ndërprerjet.....   | 19 |

|   |                                     |
|---|-------------------------------------|
| Neni 36: Dispozitat ndëshkimore dhe administrative..... | 20                                  |
| Neni 37: Ankesat .....                                  | 20                                  |
| <b>KREU VIII: TË NDRYSHME</b> .....                     | <b>20</b>                           |
| Neni 38: Gjuhët .....                                   | 20                                  |
| Neni 39: Dispozitat shfuqizuese .....                   | 20                                  |
| Neni 40: Hyrja në fuqi.....                             | <b>Error! Bookmark not defined.</b> |

Në mbështetje të nenit 4 nënparagrafi 3.6, nenit 27 paragrafi 1 dhe nenit 47 të Ligjit nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 4/14 e datës 14 janar 2016) Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit nxjerr:

## **RREGULLORE NR.06/2016 PËR NDËRPRERJE NGA SHËRBIMET E UJIT NË KOSOVË**

### **KREU I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### Neni 1: Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë bazat për ndërprerje të shërbimeve të ujit, procedurat e ndërprerjes, rilidhjen e shërbimeve të ujit nga ofruesi i shërbimeve dhe lidhjen e marrëveshjes për pagesë ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe konsumatorëve.

#### Neni 2: Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj rregulloreje ka të bëjë me ndërprerje, rilidhje të shërbimit të ujit dhe me marrëveshje për pagesë të cilat konsumatorët dhe ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë duhet t'i përmbahen.

#### Neni 3: Përkufizimet

1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore do të kenë kuptimin si në vijim:
  - 1.1. **Autoriteti** - Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit (ARRU) si autoritet i pavarur, përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit në Kosovë;
  - 1.2. **Ditë Pune** - çdo ditë përveç të shtunës dhe të dielës, apo ndonjë ditë tjetër që është festë zyrtare në Kosovë;
  - 1.3. **Faturë** - dokumenti komercial për të paguar shërbimet e ofruara, e cila saktëson, së paku shumën e borxhit për pagesë dhe periudhën për të cilën janë ofruar shërbimet, të lëshuar nga ofruesi i shërbimeve për konsumatorët, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës;
  - 1.4. **Paradhënie** – pagesa e avansit në të holla për shërbimet e ardhshme;

- 1.5. **Gypi i lidhjes së konsumatorit** - gypi nga rrjeti shpërndarës i ofruesit të shërbimeve deri te ujëmatësi i konsumatorit, apo deri te objekti i konsumatorit (në rastet kur ujëmatësi është brenda objektit të konsumatorit) i cili përbëhet prej dy pjesëve:
- 1.5.1 **Gypi shërbimit** - pjesa e gypit të lidhjes që shtrihet prej gypit shpërndarës në rrugë deri te kufiri i pronës së konsumatorit dhe mirëmbajtja e tij është përgjegjësi e ofruesit të shërbimeve;
  - 1.5.2 **Gypi i furnizimit** - pjesa e gypit të lidhjes prej kufirit të pronës së konsumatorit (d.m.th brenda kufirit të pronës ) dhe mirëmbajtja e tij është përgjegjësi e konsumatorit;
- 1.6. **Komisioni këshillues i konsumatorëve** - komisioni i përshkruar dhe i themeluar në pajtim me nenin 26 të Ligjit Nr.05/L-042;
- 1.7. **Komisioni shqyrtues** – komisioni i cili mund të rishikojë vendimet e autoritetit konform ligjit nr 05/L-42
- 1.8. **Konsumator** - personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimit dhe/ose merr shërbime nga ofruesi i shërbimeve;
- 1.9. **Kontestimi i besueshmërisë së faturës** - kontestimi i faturës i inicuar me shkrim nga konsumatori para se asaj fature t'i kalojë afati për pagesë;
- 1.10. **Kontrata e shërbimeve** - kontrata standarde e cila lidhet në mes të ofruesit të shërbimeve dhe konsumatorit, i cili rregullon ofrimin e shërbimeve, të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese;
- 1.11. **Konsumatori që nuk paguan** – cilido konsumator i cili ka mbetur njëzet (20) ditë ose më shumë pa paguar faturën. Në këtë kategori nuk klasifikohen:
- 1.11.1 Konsumatori që nuk ka pranuar faturën nga ofruesi i shërbimeve;
  - 1.11.2 Konsumatori i cili nuk e ka marrë faturën në gjuhën e tij të preferuar;
- 1.12. **Lidhje e autorizuar** – lidhja në mes të objekteve të konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura të ofruara nga ofruesi i shërbimeve sipas ligjit;
- 1.13. **Lidhje e paautorizuar** - lidhja në mes objekteve të konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura që nuk është kryer nga ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura në pajtim me ligjin;
- 1.14. **Llogaria e papaguar** - llogaria në mes të konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të ujit e cila nuk është rregulluar nga konsumatori në kohën e paraparë për të paguar;

- 1.15. **Marrëveshja e pagesës** – marrëveshje e lidhur ndërmjet ofruesit të shërbimeve të ujit dhe konsumatorit për pagesë të borxhit që ka konsumatori ndaj ofruesit të shërbimeve;
- 1.16. **Ndërprerje** - ndërprerje e ofrimit të shërbimeve nga ofruesi i shërbimeve për shkaqe të sigurisë, operacionale, mospagesës së faturave nga ana e konsumatorit apo për shkaqe tjera të përcaktuara me ligj;
- 1.17. **Njoftim** - njoftim për konsumatorët në gjuhët zyrtare për ndonjë aktivitet të caktuar të ofruesit të shërbimeve;
- 1.18. **Objekti** - lokacioni për të cilin kërkohen apo ofrohen shërbimet;
- 1.19. **Ofruesi i shërbimeve** - çdo ofrues i shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizuesit të ujit më shumicë;
- 1.20. **Pajisjet e shërbimeve të ujit** - gypat, valvulet, ujëmatësit, dhe pajisjet tjera të gypit të lidhjes të cilat menaxhohen nga ofruesit e shërbimeve;
- 1.21. **Person i cenueshëm** – çdo person fizik, jeta ose shëndeti i të cilit konsiderohet të jetë në rrezik, në mungesë të shërbimeve të ujit, me kusht që ky fakt të konfirmohet nga mjeku i licencuar ose cilido konsumator që nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale konsiderohet si person i varfër, i cili rast i'u është bërë me dije ofruesve të shërbimit të ujit se gëzon të drejtën që faturat e tij të paguhen nga organet kompetente të mirëqenies sociale;
- 1.22. **Person** - person fizik apo juridik i cili mund të jetë publik apo privat;
- 1.23. **Rilidhje** – rivendosja e lidhjes nga ofruesi i shërbimeve i cili ka ekzekutuar ndërprerjen;
- 1.24. **Regjistri i konsumatorëve** - regjistri i krijuar dhe i mbajtur nga ofruesi i shërbimeve mbi të dhënat e konsumatorëve;
- 1.25. **Rrjeti i kanalizimit** - të gjitha asetet e shfrytëzuara nga ofruesi i shërbimeve për ofrimin e shërbimeve të ujërave të ndotura;
- 1.26. **Rrjeti i ujësjellësit** - të gjitha asetet e shfrytëzuara nga ofruesi i shërbimeve për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit;
- 1.27. **Shërbimet e ujit** - shërbimet e ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizimi i ujit me shumicë;

- 1.28. **Shërbimet e ujësjellësit** - marrja, përpunimi dhe shpërndarja e ujit për konsum njerëzor si dhe operimi i rrjetit dhe objekteve për atë qëllim;
- 1.29. **Shërbimet e ujërave të ndotura** – grumbullimi, bartja, trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të ndotura të përdorura nga shfrytëzuesit shtëpiak, komercial, industrial dhe publik;
- 1.30. **Shërbimet e kanalizimit** - shërbimet në infrastrukturën fizike të cilat shërbejnë për të përcjellur ujërat e ndotura;
- 1.31. **Vërejtja për ndërprerje** - njoftimin të cilin ofruesi i shërbimeve i jep konsumatorit para se të ndodhë ndërprerja.

#### Neni 4: Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregullore:

1. Çdo fjalë apo shprehje e përdorur, të cilat nuk janë veçanërisht të definuara këtu dhe të cilat mund të jenë të paqarta, do të përmbajnë kuptimin siç janë të përcaktuara në aktet ligjore të aplikueshme në Kosovë;
2. Referencat do të interpretohen sipas kuptimit të çdo rregulloreje të lëshuar, ndryshuar, plotësuar, ose të zëvendësuar nga Autoriteti kohë pas kohe në pajtim me kompetencat që i janë dhënë Autoritetit;
3. Fjalët që përdoren në çfarëdo gjinie do të përfshijnë edhe gjininë tjetër.

#### Neni 5: Aplikueshmëria

Të gjithë ofruesit e shërbimeve janë të obliguar që të jenë në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, përfshirë amandamentimet që Autoriteti mund t'i bëjë kohë pas kohe në të.

#### Neni 6: Parimet e përgjithshme

1. Ndërprerjet dhe rilidhjet janë të kufizuara vetëm për shërbimet e ujësjellësit;
2. Asnjë ofrues i shërbimeve të ujësjellësit nuk mund të ndërpresë nga shërbimet asnjë person, përveç se në pajtim me kontratën e shërbimit sipas ligjit, apo rregulloret e tjera lidhur me ndërprerjet, të nxjerra nga Autoriteti;
3. Ofruesi i shërbimeve nuk duhet të bëjë dallime të paligjshme ndaj asnjë personi për çfarëdo arsye që ka të bëjë me ndërprerje dhe rilidhje, dhe duhet të merr në konsiderim vështirësitë që paraqiten për shkak të ndërprerjes dhe rilidhjes;

4. Shërbimet e ndërprerjes dhe rilidhjes nga ofruesi i shërbimeve, duhet të jenë transparente dhe jo diskriminuese;
5. Ofruesi i shërbimeve, në çdo kohë duhet t'i ofrojë informacion konsumatorit lidhur me ndërprerjen dhe rilidhjen;
6. Njoftimi dhe vërejtja për ndërprerje duhet të shpallet/dorëzohet jo më vonë se pesë (5) ditë të punës para datës së përcaktuar për ndërprerje përveç rasteve kur vazhdimi i shërbimit krijon kushte të rrezikshme që paraqesin kërcënim për jetën, shëndetin ose sigurinë e cilitdo person dhe të rrjetit të ujësjellësit;
7. Ofruesi i shërbimeve së pari duhet të tentojë të shtyjë konsumatorin të pajtohet me kushtet e furnizimit ose të paguajë faturat e veta para inicimit të procedurave për ndërprerje;
8. Ofruesi i shërbimeve nuk mund të ndërpresë ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit për objektin e personit të cënueshëm. Ofruesi i shërbimeve, në regjistrin e konsumatorëve do të identifikojë të gjithë personat e cënueshëm për të cilët ndërprerja krijon rrezik për jetën ose shëndetin e tyre;
9. Ofruesi i shërbimeve nuk do të ndërpresë ose të refuzojë të rilidhë shërbimet e ujësjellësit në cilat do objekte në rastet kur konsumatori ose banuesi ka vërtetimin nga mjeku i çertifikuar se lëngon nga ndonjë sëmundje serioze ose ka gjendjen shëndetësore e cila do të përkeqësohet rëndë në mungesë të shërbimeve të ujësjellësit edhe në qoftë se konsumatori i tillë nuk është regjistruar si person i cënueshëm në regjistrin e konsumatorëve;
10. Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë pagesën e tarifave dhe kompensimet për shërbime, në bazë të tarifave të miratuara nga Autoriteti.

## **KREU II HETIMI DHE EKZEKUTIMI I NDËRPRERJES NGA SHËRBIMET E UJIT**

### **Neni 7: Hetimi i rastit nga ofruesi i shërbimeve para se të zbatohet ndërprerja**

1. Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë të kërcënoj me ndërprerje të shërbimeve të ujësjellësit konsumatorin i cili e informon me shkrim ofruesin e shërbimeve se ai i konteston arsyet e ndërprerjes;
2. Kur ofruesi i shërbimeve informohet lidhur me kontestimin nga ana e konsumatorit, ofruesi i shërbimeve duhet të:
  - 2.1 Hetojë kontestimin brenda një (1) muaji;
  - 2.2 Raportojë tek konsumatori rezultatet e hetimit brenda pesë (5) ditëve të punës pas përfundimit;



- 2.3 Bëjë përpjekje të zgjidhë kontestin brenda dhjetë (10) ditëve të punës;
- 2.4 Mbajë shënime me shkrim për gjithë procesin.

#### Neni 8: Ekzekutimi i ndërprerjes

- 1. Ndërprerjet do të ekzekutohen nga së paku dy (2) punëtorë të ofruesit të shërbimeve, të identifikuar në mënyrë të duhur përmes kartelës me fotografi;
- 2. Shërbimi i ujësjellësit nuk ndërpritet jashtë orarit të punës apo në ditën e cila nuk është ditë pune, përveç ndërprerjeve të parapara me nenin 10 të kësaj rregulloreje;
- 3. Në rastin kur ofruesi i shërbimeve pengohet fizikisht të ketë qasje në objektin ku duhet të bëhet ndërprerja në mënyrë të ligjshme, ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë mbështetjen e policisë për të ekzekutuar atë ndërprerje.

#### Neni 9: Pezullimi i ndërprerjes

- 1. Nëse konsumatori parashtron ankesë brenda afatit kohor në vërejtjen e specifikuar në faturë, ekzekutimi i ndërprerjes do të pezullohet deri në vendimin përfundimtar të zgjidhjes së ankesës nga ana e komisionit këshillues të konsumatorëve;
- 2. Nëse konsumatori parashtron ankesën pas procedimit të vërejtjes në kopje të fortë, ekzekutimi i ndërprerjes nuk pezullohet.

### **KREU III BAZAT DHE PROCEDURAT E NDËRPRERJES NGA SHËRBIMET E UJIT**

#### Neni 10: Ndërprerja për shkak të rrezikut të drejtpërdrejtë

- 1. Ofruesi i shërbimit mund të bëjë ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit nëse:
  - 1.1 Vlerëson se vazhdimi i ofrimit të shërbimeve paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e personave fizik;
  - 1.2 Rrjeti i shpërndarjes së shërbimeve të ujësjellësit është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes së madhe ose të shkatërrimit;
- 2. Ndërprerjet e shërbimeve bëhen në qoftë se janë ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për largimin e rrezikut ndaj jetës apo shëndetit të personave të rrezikuar të shkaktuar nga ndërprerja e tillë;
- 3. Ofruesi i shërbimeve obligohet të njoftojë Autoritetin për ndërprerjet nga paragrafi 1 i këtij neni në afatin sa më të shkurtër kohor.

### Neni 11: Ndërprerja për qëllime operacionale

1. Ofruesi i shërbimeve mund të ndërpres shërbimet për qëllime operacionale dhe të mirëmbajtjes, pasi paraprakisht të ketë njoftuar konsumatorët e atakuar dhe Autoritetin në afatin prej tri (3) ditë pune nga dita e planifikimit të ekzekutimit të ndërprerjes;
2. Në njoftimin për ndërprerje të shërbimit nga paragrafi 1 i këtij neni, ofruesi i shërbimeve duhet të përcaktojë edhe datën e rikthimit të shërbimeve të ujësjellësit.

### Neni 12: Ndërprerja me kërkesë të konsumatorit

1. Për objektin pronar i të cilit është konsumatori, ndërprerja bëhet sipas procedurave në vijim:
  - 1.1 Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë nga konsumatori të ofrojë njoftim për arsyet e ndërprerjes së shërbimeve të ujësjellësit;
  - 1.2 Konsumatori obligohet ta njoftojë ofruesin e shërbimeve për arsyet e ndërprerjes në afatin kohor jo më shumë se pesë (5) ditë të punës nga dita kur planifikohet të ekzekutohet ndërprerja;
  - 1.3 Ofruesi i shërbimeve obligohet të ekzekutoj ndërprerjen më së shumti brenda një (1) muaji nga dita e njoftimit nga konsumatori. Deri në këtë kohë konsumatori është përgjegjës për të gjitha shpenzimet e shkaktuara;
  - 1.4 Pas ekzekutimit të ndërprerjes, ofruesi i shërbimeve duhet ta heq konsumatorin nga regjistri i konsumatorëve për shërbimet e ujësjellësit;
2. Për objektin pronë e të cilit është konsumatori, por që është i banuar nga personi tjetër, ofruesi i shërbimeve mund të ndërpresë shërbimet e ujësjellësit nëse banuesi është pajtuar se objekti mund të ndërpritet. Procedurat e mëtejshme ndiqen sipas paragrafit 1 të këtij neni.

### Neni 13: Ndërprerja kur konsumatori ka shkëlur kontratën e shërbimeve dhe kartën e konsumatorit

1. Konsumatori është i obliguar t'i përmbahet kushteve të përcaktuara në kontratën e shërbimit dhe t'i përmbahet specifikave të kartës së konsumatorit;
2. Në rast të mospërmbushjes së këtyre obligimeve nga ana e konsumatorit, ofruesi i shërbimeve i përcjell vërejtjen për shkëljen e kushteve të kontratës apo kartës së konsumatorit;

3. Nëse brenda pesë (5) ditëve të punës nga dita e përcjelljes së vërejtjes konsumatori nuk ka evituar shkeljen e kushteve të kontratës së shërbimit apo kartës së konsumatorit, ofruesi i shërbimeve mund të ekzekutojë ndërprerjen;

#### Neni 14: Ndërprerja për mospagesë të faturave

1. Ofruesi i shërbimeve mund t'ia ndërpres shërbimet konsumatorit në përputhje me paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, nëse:
  - 1.1 Nuk është paguar fatura brenda afatit të përcaktuar në faturë;
  - 1.2 Nuk hyn në marrëveshje për pagesë të faturës brenda një muaji kalendarik nga data kur ajo faturë duhet të paguhet;
  - 1.3 Nuk e bën pagesën e kërkuar në pajtim me marrëveshjen për pagesë;
2. Në rast të mospërbushjes së obligimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, ofruesi i shërbimeve i përcjell vërejtjen për ndërprerje konsumatorit;
3. Nëse brenda pesë (5) ditëve të punës nga dita e përcjelljes së vërejtjes konsumatori nuk i ka përmbushur obligimet nga paragrafi 1 i këtij neni, ofruesi i shërbimeve mund të ekzekutojë ndërprerjen.

#### Neni 15: Ndërprerja për objektin i cili është i lidhur në mënyrë të pa autorizuar

1. Asnjë konsumator nuk mund të lidhet në mënyrë të pa autorizuar;
2. Ofruesi i shërbimeve mund të iniciojë procedurë penale në gjykatën kompetente ndaj cilitdo person fizik dhe juridik i cili ka kryer shkelje në bazë të Kodit Penal të Kosovës;
3. Çdo lidhje e paautorizuar në rrjetin e ujësjellësit duhet të ndërpritet brenda pesë (5) ditëve të punës nga data e zbulimit, përveç nëse personi i lidhur në mënyrë të paautorizuar nënshkruan kontratën për shërbime me ofruesin e shërbimeve dhe paguan të gjitha ngarkesat e faturuara nga ofruesi i shërbimeve, në bazë të rregulloreve dhe tarifave të miratuara nga Autoriteti.

#### Neni 16: Ndërprerja për shkak të refuzimit të konsumatorit për të pasur qasje në pronë

1. Ofruesi i shërbimeve ka të drejtë të kërkojë qasje në pronën e konsumatorit më qëllim të instalimit apo leximit të njehsorit, inspektimit dhe riparimit të cilësdo pasuri të ofruesit të shërbimeve;
2. Ndërprerja e shërbimeve të ujësjellësit mund të bëhet nëse konsumatori i refuzon qasjen përfaqësuesit të ofruesit të shërbimeve për arsyet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni. Në këtë rast ofruesi i shërbimeve:
  - 2.1 Brenda njëzet e katër (24) orëve i procedon vërejtjen konsumatorit për ndërprerje;

- 2.2 Ekzekuton ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit pas tri (3) ditë pune, nëse konsumatori edhe më tej refuzon qasjen në pronë. Ekzekutimi ndërprerjes bëhet në pajtim me nenin 8 të kësaj rregulloreje.

Neni 17: Ndërprerjet për shkak të rrjedhjeve të jashtme të dukshme

1. Derdhja e ujit nga rrjedhjet e dukshme (jashtme), në objektet brenda pronës së konsumatorit nuk lejohet për shkak të sasisë dhe shpenzimeve për trajtimin e ujit, dhe rrjedhjet e ujërave të ndotura nuk lejohen për arsye të rrezikimit të shëndetit publik;
2. Pas identifikimit të rrjedhjes, ofruesi i shërbimeve do t'i dorëzojë konsumatorit, pronarit ose banuesit vërejtjen për sanimin e rrjedhjes, duke i ofruar një prej zgjidhjeve sipas paragrafit 3 të këtij neni;
3. Pas vërejtjes nga ofruesi i shërbimeve, qoftë për rrjedhje të ujit ose të ujërave të ndotura të cilat janë të dukshme, konsumatori duhet të riparojë rrjedhjen brenda pesë (5) ditëve të punës ose të lidhë kontratë me ofruesin e shërbimeve për riparimin me pagesë sipas tarifave të miratuara nga Autoriteti;
4. Nëse konsumatori dështon të riparojë rrjedhjen e ujit ose ujërave të ndotura brenda afatit të caktuar sipas paragrafit 3 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve mund të ndërpres shërbimet;
5. Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë paradhënien për shpenzimet që lidhen me riparimin e rrjedhjes pas kërkesës së konsumatorit për të riparuar atë rrjedhje të dorëzuar në bazë të vërejtjes sipas paragrafit 3 të këtij neni, siç është përcaktuar në urdhëresën tarifore;
6. Nëse konsumatori nuk e riparon, ose nuk kërkon të parapaguajë ofruesin e shërbimeve për riparimin e rrjedhjes brenda pesë (5) ditëve të punës nga data kur është dorëzuar vërejtja sipas paragrafit 3 të këtij neni, konsumatori do të jetë i detyruar të paguajë shpenzimet për ndërprerje, rilidhje dhe shpenzimet sipas tarifave të miratuara nga Autoriteti;
7. Nëse është e nevojshme, kurdo që të zbulohet rrjedhja në ndonjë objekt ku nuk dihet pronari, ofruesi i shërbimeve do të konsultojë komunën për objektin se kush është pronari në librat e kadastrit komunal;
8. Konsumatori do të vazhdojë të jetë i ndërprerë përderisa:
  - 8.1 Ka riparuar rrjedhjen ose ka pranuar të paguajë shpenzimet për riparimin e rrjedhjes sipas tarifave të miratuara nga Autoriteti;
  - 8.2 Ka paguar ofruesit të shërbimeve të ujit tarifën për rilidhje sipas tarifave të miratuara nga Autoriteti;

9. Ofruesi i shërbimeve duhet të riparojë cilëndo rrjedhje të raportuar nga cilido konsumator i cili ka kërkuar që ai riparim të kryhet brenda pesë (5) ditëve të punës duke siguruar që konsumatori ka paguar paradhënien për atë riparim sipas paragrafit 5 të këtij neni;
10. Nëse ofruesi i shërbimeve dështon të riparojë rrjedhjet brenda afatit të caktuar të paraparë sipas paragrafit 9 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve do të jetë i obliguar të bëjë riparimet pa kurrfarë kompensimi;
11. Konsumatori mund të kërkojë rilidhje në çdo kohë tek ofruesi i shërbimeve pasi të këtë demonstruar se rrjedhja është riparuar. Rilidhja nuk mund të refuzohet në asnjë bazë përveç nëse ka mungesë të pagesës së ndonjë fature dhe duhet të përfundohet jo më vonë se njëzet e katër (24) orë nga data e marrjes së kërkesës për rilidhje;

#### Neni 18: Ndërprerja për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të shërbimeve të ujësjellësit

1. Ofruesi i shërbimeve duhet t'i ndërpresë shërbimet secilit person i cili i shfrytëzon shërbimet e ujësjellësit në mënyrë të pa autorizuar dhe lejon shfrytëzimin e ujit nga gypi furnizues pa autorizimin e ofruesit të shërbimeve;
2. Ekzekutimi i ndërprerjes bëhet sipas nenit 8 dhe 15 të kësaj rregulloreje;

#### Neni 19: Ndërprerja në prona të braktisura

1. Kur ofruesi i shërbimeve identifikon se lidhja e shërbimit nuk është më në shfrytëzim për shkak të mungesës së banimit të njerëzve ose dëmtimit të dukshëm të strukturës së objektit që e bën të pamundur banimin e sigurtë të njerëzve, ai do të vendosë njoftimin për ndërprerje sipas nenit 22 të kësaj rregulloreje;
2. Nëse askush nuk lajmërohet gjatë periudhës së njoftimit për ndërprerje sipas paragrafit 1 të këtij neni, atëherë do të procedohet me ndërprerje. Në të kundërtën, ofruesi i shërbimeve do të bëjë hetimin sipas nenit 7 dhe të procedojë varësisht prej rezultateve të hetimit.

#### Neni 20: Ankesat drejtuar komisionit këshillues të konsumatorëve

1. Cilido konsumator i prekur nga ndërprerja ndaj të cilit nuk është vepruar në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, ose ndaj të cilit ofruesi i shërbimeve ka bërë shkelje të parapara në kartën e konsumatorëve dhe kontratën e shërbimit, mund t'i parashtrijë ankesë ofruesit të shërbimeve i cili ka bërë ndërprerjen;
2. Nëse konsumatori i cili i ka parashtruar ankesë ofruesit të shërbimeve në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk beson që ankesa e tij është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme nga ofruesi i shërbimeve brenda një muaji kalendarik nga data kur kjo

ankesë ka arritur tek ofruesi i shërbimeve, atëherë ai mund ta referojë çështjen me shkrim te komisioni këshillues i konsumatorëve që gjendet në zonën e shërbimit për ta zgjidhur.

#### Neni 21: Përlllogaritja e kohës së shfrytëzimit të shërbimeve nga konsumatori

1. Secili konsumator do të jetë përgjegjës për faturat e papaguara duke filluar nga periudha e pronësisë së vet ose posedimit;
2. Ofruesi i shërbimeve do të merr parasysh kohën posedimit ose të banimit të konsumatorit nga:
  - 2.1 Data e banimit, e cila mund të dëshmohet me:
    - 2.1.1 Datën në aplikacionin e dorëzuar nga konsumatori tek ofruesi i shërbimeve për shërbime të ujit; ose
    - 2.1.2 Data në aplikacionin e dorëzuar nga konsumatori për shërbime të rrymës ose ngrohjes qendrore;
  - 2.2 Emri dhe data e regjistrimit të pronës së patundshme;
  - 2.3 Cilindo dokument tjetër zyrtar i cili mund të shërbejë si dëshmi për datën e banimit;
3. Koha e banimit do të llogaritet në njësi të muajve të plotë duke filluar nga muaji i parë i plotë i banimit. Ditët më pak se një muaj do të përpjesëtohen në bazë të 30 ditëve të muajit.

### **KREU IV PËRMBAJTJA E NJOFTIMIT DHE VËREJTJES PËR NDËRPRERJE DHE KOMPENZIMI**

#### Neni 22: Përmbajtja e njoftimit për ndërprerje

1. Njoftimi për ndërprerje dërgohet nga ofruesi i shërbimeve do të përmbajë së paku informatat në vijim:
  - 1.1 Arsyen e ndërprerjes;
  - 1.2 Datën kur do të ekzekutohet ndërprerja;
  - 1.3 Datën kur do të rikthehet shërbimi.

#### Neni 23: Përmbajtja e vërejtjes për ndërprerje

1. Vërejtja për ndërprerje nga ofruesi i shërbimeve do të përmbajë së paku informatat në vijim:
  - 1.1 Arsyen e ndërprerjes;
  - 1.2 Obligimet që duhet ndërmarr konsumatori për t'iu shmangur ndërprerjes;
  - 1.3 Të përcaktojë afatin kohor për përmeshjen e obligimeve nga ana e konsumatorit në pajtim me nënparagrafin 1.2 të këtij paragrafi;
  - 1.4 Datën kur do të ekzekutohet ndërprerja;
  - 1.5 Datën kur do të rikthehet shërbimi.

#### Neni 24: Kompensimi

Në rast se ofruesi i shërbimeve dështon t'i përmbush procedurat e ndërprerjes të përcaktuara me këtë rregullore, atëherë:

1. Konsumatori i dëmtuar do të ketë të drejtë të kërkojë kompensim nga ofruesi i shërbimeve për dëmet e shkaktuara si rezultat i ndërprerjes;
2. Konsumatori dhe ofruesi i shërbimeve do të kenë të drejtë për të kërkuar ndihmë ligjore lidhur me atë vendim.

### **KREU V RILIDHJA NË SHËRBIME TË UJËSJELLËSIT DHE PARADHËNIA**

#### Neni 25: Rilidhja nga ofruesi i shërbimeve

1. Ofruesi i shërbimeve e rilidh objektin e konsumatorit jo më vonë se njëzet e katër orë (24) orë, pasi që:
  - 1.1 Konsumatori të ketë paguar të gjitha shumat me kohë ndaj ofruesit të shërbimeve;
  - 1.2 Të jetë arritur marrëveshja për pagesë në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje;
2. Cilado ri-lidhje e mëvonshme e objektit, qoftë me kërkesë të konsumatorit apo të ndonjë personi tjetër, trajtohet si lidhje e re dhe nuk e liron konsumatorin paraprak nga detyrimet, përkitazi me shumat e papaguara ndaj ofruesit të shërbimeve;
3. Asnjë person përveç ofruesit të shërbimeve apo personit të autorizuar nga ofruesi i shërbimeve nuk do të ekzekutoj rilidhjen e konsumatorit në shërbime.

#### Neni 26: Rilidhja e paautorizuar dhe manipulimi me ujëmatës

1. Në rast se një konsumator pasi të jetë ndërprerë nga shërbimet e ujësjellësit ri-lidhet në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 3, ai konsumator do të konsiderohet si person i lidhur i paautorizuar;
2. Ofruesi i shërbimeve pas zbulimit të ri-lidhjes së paautorizuar do të zbatojë dispozitat e parapara me nenin 15 të kësaj rregulloreje, që janë të aplikueshme për lidhjet e paautorizuara;
3. Asnjë person tjetër përveç ofruesit të shërbimeve nuk ka të drejtë të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet për matjen e ujit të konsumuar qoftë ata të vendosur në sipërfaqe publike apo në objektin e konsumatorit;

4. Në rast se një konsumator vepron në kundërshtim me paragrafin 3 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve ka të drejtë ta ndërpresë atë konsumator nga shërbimet e ujësjellësit dhe të iniciojë procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente;
5. Ofruesi i shërbimeve ka të drejtë t'i faturojë atij konsumatori edhe dëmin financiar që vlerëson se i është shkaktuar si pasojë e manipulimit me ujëmatës, pas konsultimit me Autoritetin.

#### Neni 27: Rilidhja e shërbimeve në pronat e braktisura

1. Konsumatori i cili kërkon që shërbimet e ujit të rivendosen në prona të braktisura nuk do të jetë përgjegjës për cilëndo faturë të papaguar ose borxh nga vitet e kaluara por duhet të dëshmojë që nuk ka banuar më herët në atë pronë ai ose ndonjë anëtar i familjes së tij, dhe aplikuesi duhet të paguajë taksën për rilidhje;
2. Nëse konsumatori ose ndonjë anëtar i familjes së konsumatorit ka grumbulluar borxhe në pronën e braktisur, atëherë konsumatori që kërkon vazhdimin e shërbimeve duhet të rregullojë borxhin sipas kësaj rregulloreje.

#### Neni 28: Refuzimi për rilidhje

1. Ofruesi i shërbimeve mund të refuzojë rilidhjen e konsumatorit që përsëritë mospagesën e faturave për shërbime të ujit përveç nëse ai konsumator do të kryej paradhënien sipas dispozitave të kësaj rregulloreje;
2. Nën rrethana të tilla, ofruesi i shërbimeve do të largojë pajisjet e shërbimit të ujit të konsumatorit sipas nenit 29 të kësaj rregulloreje;
3. Në rast se objekti i cili më parë është furnizuar nga ajo lidhje e shërbimeve kërkon rilidhje, qoftë nga i njëjti ose ndonjë banues tjetër, ofruesi i shërbimeve do të trajtojë atë rilidhje të shërbimit në ato objekte si lidhje të re dhe nuk e liron konsumatorin paraprak nga detyrimet përkitazi me shumat e papaguara ndaj ofruesit të shërbimit.

#### Neni 29: Konfiskimi i pajisjes për shërbime të ujit

1. Ofruesi i shërbimeve do të konfiskojë dhe të largojë nga objekti i konsumatorit të gjitha pajisjet për shërbime të ujësjellësit, duke përfshirë të gjitha pajisjet matëse të vendosura në objektin e konsumatorit në rast se konsumatori, pas ndërprerjes, vazhdimisht bën rilidhje të paautorizuar përkundër vënies së dënimeve të përcaktuara me nenin 15 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje;
2. Para se të largojë fizikisht të gjitha pajisjet për shërbimet e ujësjellësit, ofruesi i shërbimeve do të bëjë regjistrimin e të gjitha pajisjeve të cilat janë larguar, do të shënojë gjendjen e tyre dhe çfarëdo dëmtime që janë shkaktuar nga konsumatori në



ato mjete themelore që nuk kanë rrjedhë si pasojë e shfrytëzimit të kujdesshëm ose normal të aseteve të cilat do të mbahen për gjashtë (6) muaj ose derisa të rilidhet në shërbimet e ujit, cilado që ndodhë më herët;

3. Para largimit të cilësdo pajisje për shërbime të ujësjellësit nga objekti i konsumatorit, ofruesi i shërbimeve gjithashtu do të verifikojë nëse lidhja e shërbimeve është e mbyllur në mënyrë që të mos ketë rrjedhje e as rrezik nga kontaminimi në rrjetin e ujësjellësit;
4. Ofruesi i shërbimeve do të kërkojë dhe të marrë nga konsumatori kompensim të plotë për cilat do dëme të shkaktuara në pajisjet e shërbimeve të ujit nga ana e konsumatorit siç është e përshkruar dhe vlerësuar në regjistrimin e mbajtur sipas nenit 29 paragrafi 2, para se të procedohet me rilidhjen e konsumatorit në rrjetin e ujësjellësit.

### Neni 30: Paradhënia

1. Për të mundësuar rilidhjen, ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë paradhënie nga konsumatori i cili i është nënshtruar ndërprerjes. Afati i pagesës së paradhënies është (5) ditë nga dita e ekzekutimit të ndërprerjes. Ekzekutimi i rilidhjes do të bëhet brenda njëzet e katër (24) orëve nga dita e pagesës së paradhënies;
2. Paradhënia nuk duhet të tejkalojë dyfishin e mesatares së shumës totale të pagueshme të faturës mujore të konsumatorit të lëshuar për periudhën e dymbëdhjetë (12) muajve paraprak, duke mos përfshi tatimin mbi vlerën e shtuar dhe çfarëdo tatime tjera, obligimet zyrtare dhe taksat e ngarkuara në faturë nga cilido autoritet publik;
3. Paradhënia nuk do të lirojë konsumatorin nga obligimet e tij për të paguar faturat pasuese;
4. Në rastin kur konsumatori ka bërë paradhënien, por është subjekt i ndërprerjes së sërishme për shkak të dështimit të pagesës së faturave, ofruesi i shërbimeve do të përdorë paradhënien në emër të pagesës për atë llogari të papaguar, përveç nëse konsumatori, jo më vonë se katër (4) ditë të punës pasi që është ndërpre parashtron kërkesën për rilidhje në shërbimet të ujësjellësit dhe të paguajë llogarinë e papaguar. Ofruesi i shërbimeve ka të drejtë të kërkojë nga konsumatori të balancojë origjinalin e paradhënies deri në shumën maksimale të përcaktuar sipas paragrafit 2 të këtij neni;
5. Ofruesi i shërbimeve do të përdorë paradhënien për pagesën e faturave pasuese derisa ajo paradhënie të mos tregojë bilancin zero që nga muaji i parë për dymbëdhjetë (12) muaj të pandërprerë ku konsumatori ka paguar të gjitha faturat, duke përfshirë cilatdo shuma komulative të pagueshme sipas marrëveshjes për pagesë, brenda afateve të pagesës.

## KREU VI MARRËVESHJA PËR PAGESË

### Neni 31: Marrëveshjet për pagesë

1. Kur konsumatori nuk është në gjendje t'i paguajë faturën ofruesit të shërbimeve, sipas ligjit Nr.05/L-042 shërbimi i ujit për konsumatorin do të vazhdohet me kusht që ofruesi i shërbimeve dhe konsumatori të pajtohen për marrëveshjen e pagesës;
2. Marrëveshja për pagesë do të përcaktojë se:
  - 2.1 Konsumatori e pranon borxhin e krijuar ndaj ofruesit të shërbimeve në shumën e caktuar, për pranimin e shërbimeve të ujit, e cila shumë përjashton çfarëdo shume tjetër të borxhit të kontestuar ligjërisht nga konsumatori;
  - 2.2 Konsumatori pranon të paguajë borxhin e akumuluar ndaj ofruesit të shërbimeve dhe faturat pasuese për shërbimet e marra;
  - 2.3 Konsumatori e pranon metodën e pagesës së totalit të borxhit të akumuluar, e cila përbëhet nga:
    - 2.3.1 Pagesa fillestare që do të paguhet menjëherë nga konsumatori pas nënshkrimit të marrëveshjes;
    - 2.3.2 Këstet mujore që përbëhen nga shuma e mbetur e borxhit të akumuluar e ndarë proporcionalisht në këste për një periudhë që nuk tejkalon njëzetekatër (24) muaj dhe shuma e faturuar në muajin përkatës;
3. Ofruesi i shërbimeve do t'ia ofrojë një kopje të draftit marrëveshjes konsumatorit jo më vonë se pesë (5) ditë të punës pas datës kur konsumatori është ofruar për të lidhur marrëveshjen për pagesë, për t'i dhënë konsumatorit mundësinë për shqyrtim dhe verifikim të kushteve të asaj marrëveshje për pagesë;
4. Drafti i marrëveshjes për pagesë duhet që në mënyrë specifike të theksojë se:
  - 4.1 Dështimi për të respektuar marrëveshjen për pagesë mund të shpie në ndërprerje;
  - 4.2 Nëse cilido këst i pagueshëm sipas marrëveshjes për pagesë nuk paguhet brenda një muaji kalendarik nga data kur duhet të paguhet kësti i tillë, e tërë shuma e papaguar sipas marrëveshjes për pagesë menjëherë bëhet e pagueshme përpos nëse ka masa të tjera për të cilat është arritur marrëveshja me konsumatorin për të kompensuar këtë mospagesë;
  - 4.3 Konsumatori ka të drejtë të kontaktojë me komisionin këshillues të konsumatorëve nëse konsumatori nuk pajtohet me kushtet e draft marrëveshjes;
  - 4.4 Marrëveshja për pagesë duhet të miratohet brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data e pranimin të draftit të asaj kontrate;
5. Nëse konsumatori dështon të lidhë marrëveshje të pagesës me ofruesin e shërbimeve

për pagesën e çfarëdo fature të cilat konsumatori i ka borxh për shërbimet e ofruara brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data e pranimit të atij drafti të marrëveshjes ose nga cilido vendim i marrur përkitazi me atë nga komisioni këshillues i konsumatorëve, ofruesi i shërbimeve mund të konsiderojë se konsumatori ka refuzuar të hyjë në marrëveshjen për pagesë dhe do të ndërpresë atë konsumator brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara me këtë rregullore.

### Neni 32: Kontestimi i besueshmërisë së faturave

1. Kontestimi i besueshmërisë të faturave bëhet me shkrim, në çfarëdo shume të caktuar për t'i paguar llogaritë e papaguara në faturat e tanishme ose në marrëveshjen e pagesës;
2. Ofruesi i shërbimeve nuk duhet të ndërpres shërbimet e ujësjellësit përderisa nuk përfundojnë hetimet sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje;
3. Secili hetim për kontestimin e besueshmërisë të faturës duhet të përfshijë:
  - 3.1 Kontrollimin e shënimeve të ofruesit të shërbimeve për të identifikuar datën dhe shumën e faturave të dërguara tek konsumatori si dhe datën e shumën e paguar nga konsumatori;
  - 3.2 Kontrollimin e dëftesave të konsumatorit për pagesa;
  - 3.3 Përmbledhjen e rezultateve që tregojnë shumën totale të cilën konsumatori e ka borxh;
4. Ofruesi i shërbimeve duhet t'ia raportojë konsumatorit rezultatet e hetimit të bërë në pajtim me nenin 32 paragrafi 3 dhe të ruaj shënimet për së paku dy (2) vite pasi që rezultatet e hetimit të jenë raportuar tek konsumatori;
5. Ofruesi i shërbimeve duhet të sigurohet se:
  - 5.1 Faturës nuk i ka tejkaluar afati për pagesë;
  - 5.2 Shuma e faturës për atë muaj është së paku 20% më e madhe se mesatarja sezonale e konsumit të paguar nga ai konsumator gjatë periudhës paraprake dymbëdhjetë (12) muajsh; dhe
6. Kontestimet e besueshmërisë të faturave që nuk mund të zgjidhen në mes të ofruesit të shërbimeve dhe konsumatorit mund t'i drejtohen komisionit këshillues të konsumatorëve me kërkesë të konsumatorit sipas procedurave të krijuara për ato komisione.

### Neni 33: Pagesat për vërejtje, ndërprerje dhe rilidhje

1. Kur ofruesi i shërbimeve dërgon vërejtje, ekzekuton ndërprerje dhe rilidhje, atëherë shpenzimet e ofruesit të shërbimeve për punët e kryera mund të shtohen në faturën e atij konsumatori;
2. Pagesat që i referohen paragrafit 1 të këtij neni duhet të llogariten dhe të ngarkohen sipas urdhëresës tarifore.

## **KREU VII: ZBATIMI, DËNIMET DHE ANKESAT**

### Neni 34: Zbatimi i rregullores për ndërprerje dhe rilidhje

1. Autoriteti do të monitorojë/inspektoj respektimin e procedurave për ndërprerje dhe rilidhje të përcaktuara me këtë rregullore dhe mund të ndërmarrë veprime të zbatueshme ose vendime për tarifa të shërbimit bazuar në nivelin e respektimit nga ofruesi e shërbimeve;
2. Monitorimi/inspektimi i respektimit të procedurave për ndërprerje dhe rilidhje të përcaktuara me këtë rregullore do të bëhet në bazë të:
  - 2.1 Shënimeve dhe raporteve të përgatitura dhe të mbajtura nga ofruesi i shërbimeve sipas kërkesave të Autoritetit, dhe
  - 2.2 Inspektimit direkt në terren nga Autoriteti.

### Neni 35: Shënimet dhe raportet mbi ndërprerjet

1. Raportet për Autoritetin: Secili ofrues i shërbimeve duhet të përgatisë dhe dorëzojë raportet për ndërprerje tek Autoriteti në formatin e përkthuar dhe brenda intervaleve të specifikuar nga Autoriteti kohë pas kohe;
2. Raporti i progresit: Secili ofrues i shërbimeve duhet të dorëzojë raport për çdo muaj më së largu deri më datën 20 (njëzet) të çdo muaji vijues lidhur me ndërprerjet dhe shënime tjera të kërkuara ad hoc nga Autoriteti. Formatin e raportit kohë pas kohe specifikohet dhe miratohet nga Autoriteti;
3. Lokacioni i ruajtjes së shënimeve: të gjitha shënimet lidhur me ndërprerje do të mbahen në zyrën kryesore të ofruesit të shërbimeve dhe do të jenë në dispozicion gjatë orarit të rregullt të punës për t'u kontrolluar nga Autoriteti;
4. Periudha e mbajtjes së të dhënave raportuese: Të gjitha të dhënat dhe raportet e parapara në këtë nen duhet të organizohen dhe mbahen nga ofruesi i shërbimeve për

së paku pesë (5) vjet nga data kur janë përgatitur së pari ose mbesin deri atëherë kur ndonjë ligj tjetër i aplikueshëm përcakton se ato duhet të mbahen për ndonjë periudhë kohore më të gjatë në të cilin rast periodha e fundit e mbajtjes do të zbatohet;

5. Raporti i inspektimit: Duke vepruar në pajtim me nenin 34 paragrafi 2.2 të kësaj rregulloreje ekipi inspektues i Autoritetit duhet të dorëzojë raportin me shkrim nga të gjeturat në teren.

#### Neni 36: Dispozitat ndëshkimore dhe administrative

Dështimi për të respektuar cilëndo prej procedurave dhe afateve të caktuara me këtë rregullore do të ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi.

#### Neni 37: Ankesat

1. Ofruesi i shërbimeve mund të ankohet për cilindo vendim të Autoritetit në lidhje me këtë rregullore tek komisioni shqyrtues;
2. Ofruesi i shërbimeve gjithashtu mund të ankohet në gjykatën me juridiksion kompetent të Kosovës për cilindo vendim të komisionit shqyrtues që është marrë në ndonjë rast konkret sa i përket zbatimit të ndërprerjes të përcaktuara me këtë rregullore dhe ligjit Nr.05/L-042.

### **KREU VIII: TË NDRYSHME**

#### Neni 38: Gjuhët

1. Kjo rregullore miratohet dhe publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës;
2. Në rast të ndonjë mospërputhje në mes të versioneve në të cilat është nxjerrë, versioni në gjuhën shqipe do të mbizotërojë.

#### Neni 39: Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet:

1. Rregulla për shkyçjet e shërbimeve të ujit nga ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë (R-05/U&K) e datës 20 korrik 2010;
2. Vendimi për ndryshimin e shtojcës 1 të rregullës për shkyçjet e shërbimeve të ujit nga ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë (R-05/U&K) e datës 20 korrik 2010 me numër të protokollit 559 e datës 26.12.2014;

3. Rregulla për faljen dhe rregullimin e borxheve të vjetra nga ofruesit e shërbimeve të ujit dhe të kanalizimit në Kosovë e datës 14 Nëntor 2014.

Neni 40: Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Drejtori i Autoritetit.



.....  
Raif Preteni  
Drejtör i Autoritetit

